

Disa nga pikat kryesore të analizës së D+ janë:

- Ministria e Integrimit Evropian mund të bëhet pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme në kuptim organizativ dhe strukturor, por në kuptim funksional ka efekte negative në agjendën për integritime evropiane sepse e bënë atë pjesë të punëve të jashtme kurse agjenda për integritime evropiane në masë të madhe është agjendë e brendshme e reformave;
- Po ashtu, ulet niveli i përgjegjësisë së ministrive (departamenteve për integritim evropian), komunave dhe institucioneve tjera në zbatimin e mëtejme të obligimeve që dalin nga agjenda për integritime evropiane dhe kuadri profesional në MIE mund të shpërndahet nëpër departamentet e MPJ.
- Ministria e Administratës Publike sipas funksioneve që ka nuk lidhet aspak me funksionet që ka Ministria e Punëve të Brendshme. Derisa MAP ka në fushëveprim shërbimin civil, organizimin dhe funksionimin e administratës, MPB ka të lidhur fushëveprimin e saj me rendin dhe sigurinë publike, etj.